


Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

Tremujori III, 2020

Tiranë, më 03 Dhjetor 2020: Në tremujorin e tretë të vitit 2020, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit arriti 98,2 duke shënuar një ulje me 4,1 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2019.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit, në tremujorin e tretë 2020, shënoi ulje me 0,8 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2020.

Fig. 1 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit



Ndryshimi vjetor: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit në seksionin "Industri Nxjerrëse" në tremujorin e tretë 2020, ka shënuar ulje me 19,5 %. Brenda këtij seksioni ulja më e madhe e çmimeve është shënuar në aktivitetin "Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror" me 31,3 %, ku impaktin më të madh e ka dhënë muaji Shtator. Indeksi i Çmimeve të Prodhimit, në seksionin "Industri përpunuese" ka shënuar ulje me 0,6 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2019. Brenda këtij seksioni ulje më të madhe kanë pësuar çmimet në aktivitetin "Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës" me 7,7 %, pasuar me çmimet në aktivitetin "Metalurgjia" me 4,1 %.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për Produktet Vendase: Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2019, indeksi shënoi ulje me 2,7 %. Uljen më të madhe e kanë shënuar çmimet e prodhimi në seksionet "Industri nxjerrëse" dhe "Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar" përkatësisht me 11,7 % dhe 4,4 %.

Indeksi i Çmimeve të Eksportit: Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2019, indeksi shënoi ulje prej 5,3 %. Ulja më e madhe e çmimeve prej 29,6 % është shënuar në seksionin “Industri Nxjerrëse”.

Ndryshimi tremujor: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit, krahasuar me tremujorin e dytë 2020, shënoi ulje me 0,8 %. Ulje kanë pësuar çmimet në seksionin “Industri Përpunuese” me 0,9 %. Brenda këtij seksioni mund të veçojmë uljen e çmimeve në aktivitetin “Metalurgjia” me 6,4 %. Indeksi i Çmimeve të Prodhimit, në seksionin “Industri Nxjerrëse” ka shënuar rritje me 11,3 %. Brenda këtij seksioni rritja më e madhe e çmimeve është shënuar në aktivitetin “Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror” me 40,2 %.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për Produktet Vendase: krahasuar me tremujorin e dytë 2020, indeksi shënoi ulje me 0,3 %. Uljen më të madhe e kanë shënuar çmimet në seksionin “Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar” me 2,1 %.

Indeksi i Çmimeve të Eksportit: Krahasuar me tremujorin paraardhës indeksi shënoi rritje me 0,6 %. Rritja më e madhe prej 14,4 % është shënuar në çmimet e prodhimit në seksionin “Industri Nxjerrëse”.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

2010=100

NVE	Përshkrimi	Peshat	7- 20	8- 20	9- 20	III-20
	Gjithsej	100.0	98.5	98.1	98.0	98.2
B	Industri Nxjerrëse	9.8	88.8	89.5	87.3	88.5
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	5.1	80.2	79.9	74.3	78.1
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	3.6	87.7	89.7	90.9	89.4
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	1.1	106.8	106.6	106.6	106.7
C	Industri Përpunuese	53.5	103.3	102.3	102.3	102.7
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	10.1	102.9	102.8	102.9	102.9
11	Prodhimi i pijeve	1.7	104.9	104.9	104.8	104.8
13	Përpunimi i tekstileve	0.7	102.6	102.6	102.6	102.6
14	Konfeksionimi i veshjeve	3.9	108.5	108.5	108.2	108.4
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	4.5	108.9	109.0	109.0	109.0
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	0.9	109.8	109.9	109.9	109.8
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	0.9	105.1	107.1	105.2	105.8
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	1.5	98.0	98.0	97.9	98.0
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	0.2	98.5	98.5	98.5	98.5
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	1.1	108.2	107.9	107.9	108.0
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	1.0	95.6	95.6	95.6	95.6
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	1.5	115.1	115.2	115.2	115.2
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	6.5	98.1	98.4	98.3	98.2
24	Metalurgjia	7.2	91.9	85.0	85.3	87.4
25	Prodhimi i produkteve metalike të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	6.5	104.1	104.3	104.2	104.2
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0.2	116.7	116.7	116.7	116.7
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	0.7	101.9	101.9	101.9	101.9
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p,k,t	0.4	115.2	115.2	115.2	115.2
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	0.3	100.8	100.8	100.8	100.8
30	Pajisje të tjera transporti	0.0	106.0	106.0	106.0	106.0
31	Prodhimi i mobiljeve	2.9	115.7	115.3	115.3	115.4
32	Industri të tjera p,k,t	0.3	91.0	91.0	91.0	91.0
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0.5	106.5	106.5	106.5	106.5
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar	31.7	96.0	96.2	96.7	96.3
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	31.7	96.0	96.2	96.7	96.3
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	5.0	105.6	105.6	105.5	105.6
36	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	2.0	123.9	123.9	123.9	123.9
37	Shërbime të trajtimit të kanalizimeve	0.0	101.5	101.5	101.5	101.5
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	2.9	82.7	82.7	82.7	82.7

Tab. 2 Ndryshimet tremujore dhe vjetore të Indeksit të Çmimeve të Prodhimit

					%
NVE	Përshkrimi	Peshat	III-20 / II-20	III-20 / III-19	
	Gjithsej	100.0	-0.8	-4.1	
B	Industri Nxjerrëse	9.8	11.3	-19.5	
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	5.1	40.2	-31.3	
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	3.6	-5.4	-8.9	
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	1.1	0.5	-1.6	
C	Industri Përpunuese	53.5	-0.9	-0.6	
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	10.1	0.1	0.2	
11	Prodhimi i pijeve	1.7	0.6	-0.6	
13	Përpunimi i tekstileve	0.7	-0.1	1.1	
14	Konfeksionimi i veshjeve	3.9	-0.8	1.5	
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	4.5	0.5	1.8	
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	0.9	0.0	2.0	
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letre	0.9	-2.7	0.7	
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	1.5	1.8	3.5	
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	0.2	3.0	-7.7	
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	1.1	-0.8	0.2	
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	1.0	-0.1	-0.7	
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	1.5	0.1	-0.9	
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	6.5	-0.4	-3.0	
24	Metalurgjia	7.2	-6.4	-4.1	
25	Prodhimi i produkteve metalike të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	6.5	-0.1	-1.2	
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0.2	0.5	0.8	
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	0.7	-0.4	0.8	
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p,k,t	0.4	0.1	0.8	
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	0.3	-0.3	1.2	
30	Pajisje të tjera transporti	0.0	-0.2	1.0	
31	Prodhimi i mobiljeve	2.9	-0.7	0.7	
32	Industri të tjera p,k,t	0.3	-1.1	0.5	
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0.5	0.3	1.6	
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar	31.7	-1.1	-4.1	
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	31.7	-1.1	-4.1	
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	5.0	-0.5	3.3	
36	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	2.0	0.0	5.4	
37	Shërbime të trajtimit të kanalizimeve	0.0	0.0	0.0	
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	2.9	-0.8	1.4	

Tab. 3 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas

		2010=100						
NVE	Përshkrimi	Peshat	7- 20	8- 20	9- 20	III-20	III-20 / II-20	III-20 / III-19
	Gjithsej	100.0	98.2	98.3	98.2	98.2	-0.3	-2.7
B	Industri Nxjerrëse	7.6	98.7	99.6	98.4	98.9	9.5	-11.7
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	2.9	90.7	90.2	85.1	88.7	55.8	-22.4
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	3.5	102.0	104.2	105.6	103.9	-5.6	-8.0
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	1.2	107.3	107.4	107.4	107.4	0.4	-2.4
C	Industri Përpunuese	45.4	101.3	101.4	101.3	101.4	0.0	-0.3
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	10.8	105.0	105.0	105.0	105.0	0.2	0.2
11	Prodhimi i pijeve	2.1	104.7	104.7	104.6	104.7	0.6	-0.6
13	Përpunimi i tekstileve	0.4	88.1	88.1	88.1	88.1	0.1	1.2
14	Konfeksionimi i veshjeve	1.6	108.9	108.9	108.1	108.7	-0.1	1.7
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	1.9	111.7	111.9	111.9	111.8	-0.8	2.6
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	0.7	110.5	110.5	110.5	110.5	0.2	2.1
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	0.2	96.2	95.7	96.3	96.1	0.3	-0.7
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	2.0	98.0	98.0	97.9	98.0	1.8	3.5
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	0.1	98.6	98.6	98.6	98.6	0.0	0.0
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	0.9	100.0	100.0	100.0	100.0	-0.2	1.7
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	1.6	110.9	110.9	110.9	110.9	0.2	-1.2
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	7.2	86.8	87.2	87.0	87.0	-0.6	-3.3
24	Metalurgjia	3.2	88.6	88.6	88.6	88.6	0.6	-1.6
25	Prodhimi i produkteve metalike të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	7.0	97.0	97.3	97.2	97.2	-0.1	-0.4
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0.1	109.0	109.0	109.0	109.0	-0.2	0.9
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	0.2	105.6	105.6	105.6	105.6	-0.4	-0.1
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	0.2	116.2	116.2	116.2	116.2	0.0	1.3
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove	0.1	99.2	99.2	99.2	99.2	-0.4	1.1
30	Pajisje të tjera transporti	0.0	102.5	102.5	102.5	102.5	0.0	0.2
31	Prodhimi i mobiljeve	3.2	120.2	120.3	120.3	120.2	-0.1	0.9
32	Industri të tjera p,k,t	0.1	95.4	95.4	95.4	95.4	-0.1	1.5
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0.6	115.1	115.1	115.1	115.1	0.3	1.6
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar	41.2	96.0	96.0	95.9	96.0	-2.1	-4.4
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	41.2	96.0	96.0	95.9	96.0	-2.1	-4.4
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	5.8	112.9	112.9	112.9	112.9	-0.7	4.2
36	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	2.8	123.9	123.9	123.9	123.9	0.0	5.4
37	Shërbime të trajtimit të kanalizimeve	0.0	101.5	101.5	101.5	101.5	0.0	0.0
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	3.0	80.2	80.2	80.2	80.2	-1.3	0.6

Tab. 4 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për eksport

		2010=100						
NVE	Përshkrimi	Peshat	7- 20	8- 20	9- 20	III-20	III-20 / II-20	III-20 / III-19
	Gjithsej	100.0	99.2	97.4	97.6	98.1	0.6	-5.3
B	Industria Nxjerrëse	15.6	73.1	73.5	70.1	72.2	14.4	-29.6
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	11.2	68.5	68.4	62.9	66.6	29.3	-37.4
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	3.9	77.9	79.9	80.9	79.6	-4.7	-11.4
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0.6	104.1	102.4	102.8	103.1	1.2	3.9
C	Industria Përpunuese	75.0	104.7	102.0	102.0	102.9	-2.5	-1.1
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	8.5	98.2	98.2	98.2	98.2	0.1	0.1
11	Prodhimi i pijeve	0.7	97.7	97.7	97.7	97.7	0.0	0.0
13	Përpunimi i tekstileve	1.6	109.8	109.8	109.8	109.8	-0.2	1.0
14	Konfeksionimi i veshjeve	9.9	108.2	108.1	108.2	108.2	-1.0	1.4
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	11.6	110.3	110.5	110.4	110.4	1.1	1.5
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1.6	105.2	105.4	105.4	105.3	-0.1	1.8
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	2.5	108.0	110.7	108.2	109.0	-3.5	0.5
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	0.6	91.7	91.7	91.7	91.7	3.8	-9.5
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	1.7	121.8	121.1	120.9	121.3	-1.4	-1.5
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	0.2	100.3	100.3	100.3	100.3	-1.7	-2.0
22	Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës	1.2	120.4	120.4	120.4	120.4	-0.3	0.5
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	4.7	149.4	148.7	149.7	149.3	0.5	-1.6
24	Metalurgjia	17.6	95.2	84.5	85.0	88.2	-9.6	-5.5
25	Prodhimi i produkteve metalike të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	5.2	109.9	109.9	109.9	109.9	0.0	-3.1
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0.4	116.7	116.7	116.7	116.7	0.7	0.8
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	2.0	100.4	100.4	100.4	100.4	-0.4	1.0
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p,k,t	0.8	115.1	115.1	115.1	115.1	0.2	0.5
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	0.9	101.0	101.0	101.0	101.0	-0.3	1.2
31	Prodhimi i mobiljeve	2.0	104.3	102.3	102.3	102.9	-3.1	0.0
32	Industri të tjera p,k,t	1.1	89.6	89.6	89.6	89.6	-1.2	0.4
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	2.7	87.5	87.5	87.2	87.4	0.7	0.9
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	2.7	87.5	87.5	87.2	87.4	0.7	0.9

Metodologjia

INSTAT llogarit dhe publikon:

- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit Gjithsej
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit të Produkteve për Tregun vendas,
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit për Eksport

Fusha e mbulimit:

Seksioni B - Industri Nxjerrëse

Seksioni C – Industri Përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar

Seksioni E - Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas degëve të ekonomisë në nivel 2-shifror. Rinovimi i shportës së ndërmarrjeve dhe produkteve realizohet çdo vit duke përdorur rezultatet e Anketës Strukturore pranë Ndërmarrjeve Ekonomike jo Bujqësore. Përcaktimi i peshave të produkteve me destinacion tregun vendas mbështetet në rezultatet e po kësaj ankete, ndërsa peshat e produkteve me destinacion eksportin mbështeten në të dhënat statistikore të Tregtisë së Jashtme.

Duke filluar nga tremujori i dytë 2014 e në vazhdim Indeksi i Çmimeve të Prodhimit ka si periudhë referuese vitin 2010 = 100. Metoda e llogaritjes së indeksit është metoda zinxhir (Laspeyres - chain index) sipas së cilës, çmimi i produktit në periudhën korente (y) krahasohet me çmimin e muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm (y – 1);

$$I_{2010}^{y,m} = \frac{100}{\frac{1}{12} \sum_{M=JAN}^{DEC} I_{2009 Dec}^{2010,M}} \times \prod_{Y=2010}^{y-1} I_{Y-1,dec}^{Y,dec} \times I_{y-1,dec}^{y,m}$$

- Pjesa e parë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve të muajit Dhjetor 2010 krahasuar me mesataren e çmimeve në vitin 2010 (2010 = 100).
- Pjesa e dytë e formulës tregon lëvizjen zinxhir të indeksit të çmimeve nga muaji Dhjetor 2010 deri në periudhën y-1.
- Pjesa e tretë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve nga muaji Dhjetor y-1 në muajin m të vitit y.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori.

Ndryshimi tremujor krahason nivelet e çmimit të dy tremujorëve të fundit.